



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15.2 pika (c), Nenit 26.1 dhe Kreut 9 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, të amandamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080.
- Dispozitat e Nenit 15.3 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 5 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhënë KOSTT Sh.a.
- Kërkesën e ndërmarrjes KOSTT Sh.a. për aprovimin e Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të datës 21 korrik 2010,

në seancën e mbajtur me datë 11 nëntor 2010, nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET Metodologjia e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT Sh.a.

ARSYETIM

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZrRE) me datë 21 korrik 2010 ka pranuar kërkesën e ndërmarrjes KOSTT Sh.a. për aprovimin e Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit. Pas analizave dhe komenteve të dokumentit në fjalë, ZRRE konsideron se dokumenti i plotëson kriteret e kërkuara, prandaj aprovon Metodologjinë e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit si në dispozitiv të këtij vendimi.
KOSTT Sh.a. duhet të publikojë në faqen e vet elektronike versionin e aprovuar të Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit menjëherë pas pranimi të këtij vendimi apo pas publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
- II. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkangjitur-Metodologjia e Taksave për Kyçje në Rrjetin e Transmisionit.

Bordi i ZrRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

